

**VENDIM**  
**Nr. 836, datë 30.12.2025**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 7.2.2007, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E  
PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR  
INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, togfjalëshi “... 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj ...” zëvendësohet me “... 20 480 (njëzet mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë në muaj ...”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**